Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

PRISHTINA

Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për Vetëqeverisje Lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 45, paragrafi 45.2 i Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010 dhe të nenit 4, pika 4.3 e Rregullores për procedurën e themelimit, përbërjes dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunën e Prishtinës, kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa të Kryeqytetit,

th ë rr e t

mbledhjen e **shtatë** të Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila do të mbahet më **26.11.2026** dhe do të fillojë në orën **10:00.**
Mbledhja do të mbahet në sallën nr. 37 (kati II) të Komunës së Prishtinës.
Për mbledhje propozon këtë

REND TË DITËS:

1. **Propozim-vendimi për mbështetje financiare për fëmijët dhe të rriturit me autizëm dhe sindromën Down;**
2. **Propozim-vendimi për subvencionimin e NPL-së „Sport Marketing";**
3. **Rregullorja për përcaktimin e procedurave dhe formave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për periudhën më të shkurtër se një vit;**
4. **Propozim-vendimi për formimin e Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave për Dhënien e Pronës Komunale në Shfrytëzim;**
5. **Propozim-vendimi për formimin e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave për Dhënien e Pronës Komunale në Shfrytëzim;**
6. **Propozim-vendimi për caktimin e Komisionit për Menaxhimin, Revitalizimin dhe Sistemimin e Pronave të Paluajtshme në Pronësi të Kryeqytetit;**
7. **Propozim-vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit për Formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;**
8. **Raportimi mbi performancën financiare dhe operative të N.P.K. „Trafiku Urban" Sh.A., për vitin 2025 dhe për gjashtëmujorin e parë të vitit 2026;**
9. **Raportimi i NPL-së „Gjelbër" për periudhën janar–shtator 2026;**
10. **Të ndryshme.**

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-060/01-171179/26, më 16.11.2026

KRYESUES I KOMITETIT
Fehmi Kupina